



Të mbrojmë mjedisin për të ardhmen tonë dhe vendin ku jetojmë!

Rrethanat dhe mjedisi ndikojnë mbi ne, por ne jemi përgjegjës për vetveten.

Paulo Coelho

*Në këtë buletin do të gjeni:*

**Raporti i Gjendjes në Mjedis 2021**

**Thuaji "Jo" qeseve plastike**

Faqe 1

**Sensibilizimi i brezit të ri**

**Projekt bashkëpunimi me Agjencinë Europiane të Mjedisit**

Faqe 3

**Aktivitet edukues në natyrë**

**Monitorimi i mjedisit**

**Takimi i dytë i byrosë të PRTR**

Faqe 2

**Për një mjedis të pastër gjatë sezonit veror**

**Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis**

**Menaxhimi i Raporteve të Vetëmonitorimit të operatorëve**

Faqe 4

**Kontrolli dhe inspektimi i mjedisit**

**Bashkëpunimi me projektin e GIZ**

**Pajisja me leje mjedisore**

Faqe 5

**Një studim rasti në Ballkanin Perëndimor për ndikimet e PM 2.5 dhe ozonit**

**Kompostimi i mbetjeve organike**

Faqe 6

## Raporti i Gjendjes në Mjedis 2021

Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka përgatitur dhe publikuar Raportin e Gjendjes në Mjedis për vitin 2021. Ky raport përmban 11 kapituj dhe paraqet vlerësimin e gjendjes së mjedisit për komponentët kryesorë të mjedisit, ku përmendim;

- Ujërat sipërfaqësore dhe nëntokësore
- Mjedisi detar
- Ndryshimet klimatike
- Biodiversiteti dhe natyra
- Toka
- Ajri
- Zhurmat
- Mbetjet
- Kimikatet
- Aktivitetet industriale

Raporti analizon presionet që i bëhen mjedisit të cilat sjellin ndikimet në mjedis, forcat shtytëse që paraqesin burimet e ndotjes si dhe reagimet apo veprimet që duhet të kryhen për të parandaluar ndikimet negative në mjedis. Gjithashtu vlerëson tendencën e treguesve të matur ndër vite, gjë e cila ndihmon në vëzhgimin e përmirësimit apo përkeqësimit të gjendjes krahasuar me vitet e mëparshme. Paraqet rekomandime për përmirësimin e gjendjes në mjedis të cilat duhet të përfshihen në hartimin e politikave më efikase në mbrojtje të mjedisit.

Me anë të publikimit të RGJM 2021, i gjithë publiku mund të marrë njohuri për cilësinë e mjedisit ku jeton, problematikat që hasen si dhe përfshirjen e tyre në përmirësimin e gjendjes nëpërmjet rritjes së përgjegjshmërisë në mbrojtje të mjedisit.


Raportin e Gjendjes në Mjedis 2021 mund ta gjeni të publikuar në [www.akm.gov.al](http://www.akm.gov.al)



## Thuaji “JO” qeseve plastike

**Duke filluar nga 1 Qershori** ndalohej përdorimi i qeseve plastike mbajtëse transportuese me ose pa vesh, e prodhuar nga plastika, me trashësi për çdo anë më të vogël se 70 mikron dhe me kapacitet mbajtës më të vogël se 10 kilogramë me përmasa më të vogla se 50 cm gjatësi dhe 24 cm gjerësi pa përfshirë gjerësinë e palosjeve (referuar Ligjit Nr 28, datë 17.03.2022 dhe VKM-së Nr 367 datë 30.5.2022).

Ky është mesazhi që përcjell fushata ndërgjegjësuere e zhvilluar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkitë e vendit tonë nëpërmjet takimeve informuese dhe sensibilizuese në rreth 3500 biznese (supermarkete /markete/ tregje).



Nëpërmjet fushatës ndërgjegjësuere synojmë të rritim përgjegjshmërinë e qytetarëve për ndalimin e përdorimit të qeseve plastike njëpërdorimshme në mbrojtje të mjedisit për të ardhmen tonë dhe vendin ku jetojmë.

Për të gëzuar një mjedis të pastër kërkohet angazhimi i të gjithë qytetarëve për përdorimin e alternativave zëvendësuese të qeseve plastike mbajtëse.

- Çantat prej tekstili.
- Çantat e letrës/kartonit
- Çantat me rrjetë prej tekstili



**Për një mjedis më të pastër sot dhe në të ardhmen!**

## Aktivitet edukues në natyrë

Mirëqenia e njeriut lidhet ngushtë me shëndetin e mjedisit. Njerëzit kanë nevojë për ajër dhe ujë të pastër për të jetuar, hapësira të gjelbra për tu shlodhur, relaksuar, për të kryer aktivitet fizik dhe rekreativ. Parqet dhe sipërfaqet me gjelbërim ndikojnë në zvogëlimin e stresit. Rivënia e kontaktit me tokën rrit besimin te vetja, lufton ankthin dhe na mëson të rigjejmë bukurinë e gjërave të vogla që e bëjnë jetën të bukur. Qëndrimi në natyrë i bën mirë si trupit ashtu edhe mendjes!

Një nga angazhimet dhe sfidat tona, është edukimi i brezit të ri me natyrën, si dhe lidhja dhe vendosja e ekuilibrave me të. Prandaj Agjencia Kombëtare e Mjedisit, ka zhvilluar aktivitete në natyrë me nxënës të shkollave 9- vjeçare me qëllim mësimin dhe mendimin kritik mbi rolin e individit, shoqërisë dhe shtetit për ruajtjen e natyrës, mjedisit dhe mbrojtjen e saj nga dëmtimet, ndotja, efektet serrë etj.



Gjatë këtyre aktivitete, u kemi shpjeguar nxënësve se sa rëndësi kanë veprimet e tyre sado të vogla për të ruajtur ekuilibrin biologjik pasi ashtu si e dimë, me rritjen e popullsisë, qëndërzimin e numrit më të madh të popullatës në zona të urbanizuara, zhvillimin e industrisë, kanë çuar në prishjen e ekuilibrave mjedisorë. Kjo sjell si pasojë ndotjen e ajrit, ujërave, uljen e sipërfaqeve të pyjeve, rritjen e nivelit të CO<sub>2</sub> i cili ndikon në krijimin e gazeve serrë dhe nxitjen e ndryshimeve klimatike.

Mjedis i QËNDRUESHËM është slogani dhe lufta jonë, pasi toka nuk na përket ne, Ne i përkasim asaj!

## Monitorimi i mjedisit

Laboratori i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është në fazën e monitorimit të cilësisë së ujërave sipërfaqësore të Shqipërisë në lumenj, liqene dhe zona bregdetare dhe monitorimit të nivelit të zhurmave të cilat janë shumë të rëndësishme për sa i përket dhënies së një vlerësimi të gjendjes së ujërave dhe të zhurmave në vendin tonë.

**Përsa i përket monitorimit të ujërave**, gjatë periudhës Maj – Gusht është realizuar kampionimi në terren dhe analizimi në Prespën e Madhe, Sarandë, Liqeni i Ohrit, Liqeni i Shkodrës, Prespë e Vogël, Lumi Drin, Baseni i Semanit, Baseni i Vjosës, Bregdeti Jon Vlorë – Ksamil dhe Velipojë.

**Monitorimi i Zhurmave** përgjatë periudhës Maj – Gusht është realizuar në Kukës, Sarandë, Fier, Vlorë, Korçë, Pogradec, Lezhë, Tiranë dhe Gjirokastrë.

## Takimi i dytë i byrosë të PRTR

Me datë 9 Qershor 2022, u mbajt takimi i njëzet e dytë i Byrosë së Protokollit të Rregjistrimit të Shkarkimit dhe Transferimit e Ndotësve (PRTR) ku vendi ynë merr pjesë me një anëtar në rolin e nënkryetarit. Gjate këtij takimi u diskutua mbi mënyrat për të lehtësuar një shkëmbim informacioni midis palëve dhe palëve të interesuara mbi temat që lidhen me zhvillimin e ardhshëm të PRTR-së dhe opsionet e mundshme për të siguruar që objektivat e Protokollit të përmbushen më mirë.

Diskutimi u përqëndrua rreth temave kyçe si zhvillimet kryesore që nga sesi i Katërt i Takimit të Palëve dhe veprimet e mundshme për të ndjekur vendimin IV/2. Në këtë kontekst, ky vendim synon t'i mbajë PRTR-ët relevante dhe gjithëpërfshirës; harmonizimi i punës ekzistuese nga Palët dhe përgjigjja ndaj qëllimeve aktuale të politikave, të tilla si transformimi në një ekonomi të qëndrueshme dhe cirkuluese; reduktimi i ndjeshëm i emetimeve të gazeve serrë dhe shkarkimeve të ndotësve; promovimi i PRTR-ve jashtë rajonit të UNECE dhe rinovimi i mbështetjes politike për PRTR.

Z. Alex Radway (Bashkimi Evropian, Nënkryetar), bëri një prezantim mbi propozimin e Komisionit Evropian për zhvillimin e E-PRTR. Propozimi kishte për qëllim harmonizimin e përmirësuar të E-PRTR dhe Direktivës Evropiane të Emisioneve Industriale dhe direktivave të tjera të lidhura me to. Ai përfshinte gjithashtu përditësimin e çdo kërkesë raportimi në mënyrë që ato të pasqyrojnë më mirë nevojat aktuale të informacionit në kontekstin e transformimit ekonomik drejt qarkullimit dhe qëndrueshmërisë dhe reformave të politikave përkatëse.



Në diskutimin e mëpasshëm, u ngritën disa aspekte të zbatimit të Protokollit, kryesisht në lidhje me krahasueshmërinë, konfidencialitetin, transparencën, nevojat kombëtare, zhvillimin historik të sistemeve ekzistuese të PRTR-it dhe synimet aktuale të politikave të lartpërmendura. Për shembull, u vu re se të dhënat e PRTR duhet të mundësojnë krahasimin e të dhënave nga objekte të ndryshme, pasi ky ishte një qëllim kryesor i PRTR-ve. Sot, krahasueshmëria në shumë sisteme PRTR ishte ende e kufizuar, pasi për shembull një objekt i madh perceptohej se çlironte më shumë ndotës sesa një vend i vogël prodhimi me teknologji të ulët, megjithëse ndot më pak për vëllim prodhimi.

Sfida e bërjes së shkarkimit dhe transferimit të të dhënave të ndotësve të krahasueshme preku gjithashtu aspekte të lidhura me pyetjen se si PRTR-të mund të kontribuojnë efektivisht në një ekonomi qarkulluese. Me ndryshimet e propozuara dhe pjesërisht të zbatuara për E-PRTR-ë, si shtimi i kërkesave të raportimit për konsumin e burimeve dhe vëllimin e prodhimit, krahasueshmëria e të dhënave do të përmirësohej dhe do të rritej dobja për qëllime të ekonomisë Qarkulluese.

Duke iu kthyer çështjeve që kanë të bëjnë me ndërgjegjësimin për PRTR-të dhe në veçanti fushëveprimin e tyre, u shpjegua se ndryshimi i emrit nga E-PRTR në *Portali Emisioneve Industriale* ishte i motivuar nga vështirësia që jo-ekspertët të angazhoheshin me akronimin “PRTR”. Megjithatë, u argumentua se emri i ri nënkupton një shpërndarje të të dhënave të shkarkimit të ndotësve të kufizuar në emetimet industriale, ndërsa Protokollin kishte dispozita në lidhje me shkarkimet në mjedis si rezultat i çdo aktiviteti njerëzor, duke përfshirë nga burime të përhapura deri në produkte. Ndryshimi i emrit pasqyroi në mënyrë efektive zhvillimin historik të PRTR në Bashkimin Evropian, dhe integrimin dhe harmonizimin e legjislacionit të ndryshëm ekzistues evropian, lidhur me shkarkimin e ndotësve industrialë dhe kërkesat për leje, si dhe Direktivën Seveso III 2012/18/BE mbi kontrollin të rreziqeve të aksidenteve të mëdha që përfshijnë substanca të rrezikshme. Zhvillime të tjera që nga sesioni i katërt i Takimit të Palëve, përfshinin Rezolutën 5/14 të titulluar “Të japim fund ndotjes nga plastika: Drejt një instrumenti ndërkombëtar ligjërish të detyrueshëm” (UNEP/EA.5/Res.14), miratuar më 2 mars 2022 nga Asambleja Mjedisore e Kombeve të Bashkuara në sesionin e saj të pestë. Në këtë drejtim, Byroja vuri në dukje mbivendosjen midis fushëveprimit të Protokollit për PRTR-të dhe fushëveprimit të një instrumenti të mundshëm në të ardhmen për t’i dhënë fund ndotjes nga plastika që nxjerr sinergji të mundshme.



**Sensibilizimi i brezit të ri**

Në kuadër të fushatës sensibilizuese që AKM ka ndërmarrë me shkollat 9-vjeçare në qarkun Tiranë, është diskutuar mbi rëndësinë e ndikimit të veprimeve tona mbi pastërtinë e mjedisit ku jetojmë. Në takimet me mësues dhe nxënës të këtyre shkollave u zhvilluan bashkëbisedime dhe veprimtari praktike për përvetësimin sa më mirë të teknikave që cojnë në reduktimin e mbetjeve. Gjatë prezantimit të modulit u realizua përfitimi i njohurive bazë të koncepteve të menaxhimit të mbetjeve dhe ekonomisë qarkulluese si dhe u vunë në pah avantazhet dhe disavantazhet e incenerimit.



Rëndësi e veçantë iu kushtua vënies në praktikë të parimit të 3R-ve (Reduktim, Ripërdorim, Riciklim) si edhe Kompostimit si një proces sa praktik aq edhe efikas. Gjithashtu u organizuan aktivitete me nxënës të këtyre shkollave për plastikën njëpërdorimshe dhe efektin negative të tyre në mjedis. Ajo që binte në sy gjatë takimeve ishte qasja mjaft positive e brezit të ri për t’ju bashkuar misionit të përbashkët “Mbro mjedisin, mbro të ardhmen tënde”.

**Projekt bashkëpunimi me Agjencinë Europiane të Mjedisit**


Në kuadër të bashkëpunimit të Agjencisë Europiane të Mjedisit (AEM) me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, është përmblyllur me sukses projekti “Rritja dhe forcimi i kapaciteteve të Shqipërisë në drejtim të zbatimit të aktiviteteve të AEM me perspektivë anëtarësimin e plotë të tyre”.

Ekspertët shqiptarë të përfshirë në aktivitetet e këtij projekti, për komponentët e ujërave dhe pritshmërive mjedisore, menaxhuan me sukses gjithë procesin, në fund të të cilit u realizuan dhe produktet e parashikuara.

Për herë të parë u krye dizenjimi dhe vlerësimi i treguesve mjedisor në fushën e cilësisë dhe sasisë së ujërave në Shqipëri në përputhje të plotë me manualët dhe metodologjitë e AEM për këtë qëllim.



Njëkohësisht e në përputhje me kapaciteteve kombëtare në drejtim të kryerjes së vlerësimit të ndikimit të Megatrendeve Globale në Gjendjen e Mjedisit në Shqipëri u realizua vlerësimi i parë i këtyre ndikimeve në nivel kombëtar, si pjesë e Raportit të Gjendjes së Mjedisit në Shqipëri



## Takimet për një mjedis të pastër gjatë sezonit veror 2022

E filluam me **Bashkinë Kavajë**, me qëllim ndërgjegjësimin për marrjen e masave për krijimin e një mjedisi të pastër në zonat bregdetare. Gjatë takimit, u informuam mbi masat kryesore që bashkitë kanë marrë mbi mbarëvajtjen e sezonit veror si dhe përmirësimin e gjendjes mjedisore në përgjithësi. Vënia në funksion e impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura urbane, që përfshin kanalizimet nga zona e quajtur “Shkëmbi i Kavajës” dhe të gjithë pjesën e qytetit dhe zonën bregdetare që menaxhon bashkia Kavajë, është një ndër masat më të rëndësishme dhe me ndikim pozitiv për sa i përket mjedisit.

**Bashkia Divjakë** po bën investime në ngritjen e rrjetit të kanalizimeve për një nga zonat dhe në vazhdim ky projekt do të shtrihet edhe në zonat e tjera të zonës bregdetare.


**Bashkia Sarandë** për sa i përket pjesës së qytetit, gjatë rregullimit të shëtitorës, është ndërhyrë edhe në pjesën e kanalizimeve të ujërave urbane, të cilat nuk derdhen më në ujërat bregdetare por shkojnë në impiantin e trajtimit të ujit i cili ndodhet në afërsi të liqeni të Butrintit. Kërkesë për ndërhyrje të thellë kërkon edhe pjesa e kanalit të Çukës, ku bashkia ka marrë masa duke bërë pastrimin dhe hapjen e kanaleve të ujërave urbane.



**Me bashkinë Vlorë** u diskutua mbi marrjen e masave për sigurimin e një mjedisi të pastër gjatë sezonit veror 2022. Këto masa synojnë vendosjen e dusheve, koshave dhe tualeteve në plazhin publik dhe privat si dhe trajtimin e ujërave të ndotur. Ujërat e ndotura trajtohen me paratrajtim dhe trajtim primar dhe impianti mbulon 75 % të rrjetit të kanalizimeve. Bashkia Vlorë, nëpërmjet një projekti që po zhvillohet, do të përmirësojë impiantin e trajtimit të ujërave të ndotur duke përfshirë trajtimin sekondar të ujërave të ndotura.

**Nga bashkia Pogradec**, u informuam mbi masat kryesore që kanë marrë për mbarëvajtjen e sezonit veror.

Për sa i përket trajtimit të ujërave të ndotura urbane, bashkia Pogradec ka në funksion impiantin e trajtimit të ujit. Ujërat e ndotura urbane shkojnë në impiantin e trajtimit të ujit nëpërmjet rrjetit të kanalizimeve i cili përfshin pothuajse të gjithë zonat përreth liqenit dhe nuk ka derdhje të patrajuara në Liqenin e Ohrit.



**Bashkitë Shkodër dhe Lezhë** kanë marrë masa për sezonin veror turistik si dhe përmirësimin e gjendjes mjedisore në përgjithësi. Ku për sa i përket pjesës bregdetare, impiantet e trajtimit të ujit janë funksionale dhe ujërat e ndotura urbane shkojnë në impiantin e trajtimit të ujit dhe nuk ka derdhje të patrajuara në vijën bregdetare.

## Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis

Agjencia Kombëtare e Mjedisit merr në shqyrtim dhe nxjerr vendimin për projektet që kanë ndikim në mjedis gjatë fazës së ndërtimit. Pjesën më të madhe të aplikimeve e zënë projektet infrastrukturore, të enteve publike dhe private.

- Në projektet publike përfshihen:
  - Rikonstruksione rrugësh, urash, ujësjellësa
  - Projektet e rindërtimit
  - Ngritje institucionesh arsimore dhe shëndetësore
  - Blloqe banimi për familjet e pastreha
- Ndër projektet private mund të përmendim:
  - Projektet në fushën e bujqësisë
  - Projektet në fushën e turizmit dhe agroturizmit

Për periudhën Maj-Gusht, 2022, janë marrë në shqyrtim dhe janë dhënë vendime për 400 projekte. Vlerësimi i projektit përfshin, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve negative ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit. Gjithashtu përfshin edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara, të cilat përfshihen në kushtet që vendosen në Vendimin e lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

Në kuadër të rëndësisë së publikut në vendimarrjen mjedisore, janë regjistruar gjithsej 151 kërkesa për procedurën e konsultimit me publikun. Procedura ndiqet në zbatim të VKM Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore”.

### Menaxhimi i Raporteve të Vetëmonitorimit të operatorëve

Në zbatim të VKM-së Nr. 568, datë 17.07.2019 “Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit dhe Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit”, Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, Sektorit i Monitorimit/Drejtoria e Inspektim-Kontrollit, për periudhën Janar–Gusht 2022 ka menaxhuar dhe grumbulluar të dhënat dhe dokumentacionin e raporteve vjetore të vetëmonitorimit si më poshtë:

#### ✚ Menaxhimi dhe grumbullimi i të dhënave dhe dokumentacionit të:

- 25 raporte vetëmonitorimi mbi zbatimin e kushteve vjetore për lejet e tipit A,
- 522 raporte vetëmonitorimi mbi zbatimin e kushteve vjetore për lejet e tipit B
- 16 raporte mbi zbatimin e kushteve vjetore të VNM Paraprake.

#### ✚ Përditësimi i të dhënave në databazën përkatëse të operatorëve, ku janë regjistruar:

- 2 operatorë që janë mbajtës të një leje mjedisore tipi A.
- 127 operatorë që janë mbajtës të një leje mjedisore tipi B.
- 11 operatorë që janë mbajtës të Deklaratës Mjedisore të Ministrit.
- 206 operatorë që janë mbajtës të Vendimit për VNM Paraprake


## Kontrolli dhe inspektimi mjedisor

Agjencia Kombëtare e Mjedisit për periudhën Maj–Gusht 2022 ka kryer 13 inspektime të skrapeve, metaleve dhe plastikës në Tiranë, dhe nuk është dhënë asnjë masë administrative.

Gjithashtu janë kryer 152 inspektime në total për fushat e veprimtarisë të mëposhtme dhe janë dhënë 19 masa administrative.

- ❖ Prodhim dhe përzierje e betonit
- ❖ Prodhim i pijeve alkoolike
- ❖ Rritja intensive e peshqëve
- ❖ Lejet e përdorimit të burimeve ujore

Në zbatim të Ligjit Nr 28, datë 17.03.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” si dhe VKM-së Nr 367 datë 30.5.2022 “Për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e RSH të qeseve plastike mbajtëse”, Agjencia Kombëtare e mjedisit ka kryer 12 inspektime në subjekte që kanë aktivitet prodhimin e qeseve plastike dhe janë dhënë 2 masa administrative.



Në kuadër të parandalimit të ndotjes dhe përmirësimit të gjendjes së mjedisit për komponentët e ujërave sipërfaqësore dhe të ujërave bregdetare, janë verifikuar 10 impiante të pastrimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura në Shqipëri të cilat do të inspektohen përgjatë muajit Shtator 2022.

## Bashkëpunimi me projektin e GIZ

Agjencia Kombëtare e Mjedisit në bashkëpunim me projektin e GIZ “Menaxhimi i modernizuar i mbetjeve të ngurta dhe ekonomia ricikluese në respekt të mjedisit”, gjatë periudhës maj-gusht ka organizuar takime ndërgjegjësuëse me përfaqësues të biznesit në bashkinë Cërrik, Sarandë Belsh, Roskovec, Himarë. Këto biznese janë të përzgjedhura nga projekti i mësipërm dhe përfshijnë supermarketet/markete, bar-restorant, hotele ku janë vendosur kosha për ndarjen e mbetjeve të kartonit/letrës.




Qëllimi i takimeve ishte për sensibilizimin e bizneseve për hedhjen e mbetjeve të kartonit/letrës që gjenerojnë në koshat e caktuar me synim grumbullimin dhe riciklimin e tyre. Ky mirëmenaxhim i mbetjeve çon në uljen e sasisë të mbetjeve që gjenerohen dhe të mbetjeve që depozitohen në landfill si dhe në rritjen e sasisë të mbetjeve të riciklueshme. Gjithashtu njohja me problemet që hasin për realizimin e ndarjes në burim shërben për ndërmarrjen e veprimeve të duhura në të mirë të mjedisit dhe të njerëzimit.



## Pajisja me leje mjedisore

Një nga aktivitetet kryesore të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit është dhënia e lejes për përdorimin e burimeve natyrore dhe mjedisit në përgjithësi për subjekte të ndryshme që aplikojnë. Menaxhon procedurën e lejeve mjedisore dhe aplikimet e marra nga QKB nëpërmjet një sistemi.



Kjo ka si objektiv, parandalimin, kontrollin, uljen e ndotjes si dhe përmirësimin e kushteve të mjedisit, cilësisë së jetës dhe shëndetit të njeriut. Qëllimi kryesor është mbrojtja, ruajtja dhe përmirësimi i mjedisit, parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Gjatë periudhës Janar-Qershor pas shqyrtimit të kërkesave për pajisjen me leje mjedisore janë miratuar :

- 5 leje tipi A
- 343 leje tipi B
- 19 liçenca III.2B

## Analiza e skenarit të PM 2.5 dhe ndikimeve të ozonit në shëndet, në të korrat dhe klimën me TM5-FASST: Një studim rasti në Ballkanin Perëndimor

Ballkani Perëndimor është një rajon në Evropën Juglindore ku përafrimi i legjislacioneve kombëtare dhe politikave me ato të Bashkimit Evropian (BE) është në progres me perspektivën e arritjes së anëtarësimit në BE.

Një proces i tillë është vendimtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit duke pasur parasysh se nivelet e ndotjes së ajrit në këtë zonë janë ndër më të lartat e Evropës dhe prek rajonet fqinje. Me qëllim të informimit të projektimit të cilësisë së ajrit, u përdor për të vlerësuar tendencat e ajrit mjete të shqyrtimit të skenarit TM5-FASST (TM5-FASST). Cilësia (PM 2.5 dhe ozoni) ndikojnë në shëndet, rendimentet e të korrave dhe klimën nga viti 2000 deri në vitin 2050. Për këtë qëllim, u krahasuan pesë skenarë emetimi ECLIPSE V6b me supozime të ndryshme mbi rritjen e popullsisë, vendosjen e teknologjive dhe politikave. Masat në bazën e legjislacionit aktual (CLE) janë efektive në zbutjen e ndikimit të parashikuara për sektorët e brendshëm energjinë dhe transportin në cilësinë e ajrit, ndërkohë që ato flasin pak mbi efektet në sektorët e bujqësisë dhe mbetjeve.

Zbatimi i skenarëve të reduktimit maksimal të realizueshëm (MFR) në Ballkanin Perëndimor do të çonte në një ulje të vdekshmërisë së lidhur me PM 2.5 prej 49%-65% në 2050 krahasuar me legjislacionin aktual. Përkundrazi, asnjë skenar i mëtejshëm kontrolli (NFC) nuk do të shkaktonte një rritje të vdekshmërisë së PM 2.5 prej 16%-21% në 2050 krahasuar me CLE. Analiza e vdekshmërisë së lidhur me ndotjen ndërkufitare sugjeron se mungesa e veprimit do të çonte në një rritje të konsiderueshme të ndikimit të emetimeve të Ballkanit Perëndimor në vendet fqinje.

Skenari MFR (për reduktimin maksimal të mundshëm) do të çonte gjithashtu në një reduktim të humbjeve bujqësore për shkak të ndotjes së ozonit prej 38%-90% në vitin 2050 krahasuar me bazën e legjislacionit aktual. Potenciali i ngrohjes globale në një shkallë kohore 20-vjeçare u realizua për të vlerësuar ndikimin afatmesëm të reduktimit të emetimeve të ndotësve të ajrit në mjedis.

Skenarët e analizuar përshkruajnë një spektër që varion nga përfitimet maksimale të kombinimit ambicioz të cilësisë së ajrit dhe politikave klimatike deri te ndikimi i moszbatimit të tyre, të miratuara aktualisht që ofrojnë një kuadër referencë për zhvillimin e politikave të qëndrueshme në rajon.

Ky studim fokusohet në Ballkanin Perëndimor, me një ajër kritik të brendshëm dhe ndërkufitar dhe me një situatë ndotjeje e cila është në një fazë transformimi të thellë për shkak të perspektivës së tyre për t'u bërë anëtarë të Bashkimit Evropian.

Ky rast studimi paraqet një shembull se si mbështetja e një zone të zhvilluar me standarte të larta mjedisore, mund të krijojë kushte për një përmirësim dhe qëndrueshmëri me perspektivë afatgjatë në rajonet e afërta më pak të zhvilluara.

Analiza e skenarit të kryer me TM5-FASST dha një gamë të projeksioneve për treguesit kryesorë të qëndrueshmërisë siç janë ndikimet në ajër, cilësinë e shëndetit dhe klimës dhe gjithashtu një tregues për një ekonomi kyçe variabël siç është prodhimi bujqësor. Përveç kësaj, skenarët ECLIPSE V6b bënë të mundur analizimin e projeksioneve gjatë disa dekadave, të cilat janë thelbësore për të kuptuar implikimet afatgjata të politikave dhe përputhshmërinë e tyre me objektivat afatgjata si ato të vendosura në SDGs dhe BE-GD, dhe në konventat ndërkombëtare si Konventa e Ajrit, Marrëveshja e Parisit dhe Komuniteti i Energjisë.

Rezultatet e këtij studimi konfirmojnë se zbatimi i politikave të miratuara aktualisht në Ballkanin Perëndimor ka të ngjarë të stabilizohet duke ulur lehtësisht ndikimin e PM 2.5 në lidhje me shëndetin dhe atë të ozonit (O<sub>3</sub>) mbi produktivitetin e bujqësisë në dekadat e ardhshme. Ndërsa ndikimi i ozonit për shëndetin ka të ngjarë të rritet. Politika të tilla janë efektive në zbutjen e ndikimit të parashikuar të prodhimit të energjisë. Megjithatë, politikave aktuale kanë pak efekt në bujqësi, menaxhimin e mbetjeve dhe burime të tjera të vogla tek të cilat ndikimi parashikohet të mbetet i qëndrueshëm ose të rritet.

Agjenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor është në përputhje me parimet e BE-së -Marrëveshja e Gjellbër. Që nga masat specifike që lidhen me Ballkanin Perëndimor, Agjenda e Gjellbër është ende në definicion, ku janë paraqitur skenarët e legjislacionit aktual (CLE) dhe MFR-së (për reduktimin maksimal të mundshëm). Analizë më specifike do të ishte e mundur kur synimet sasiore të politikave dhe afatet për këtë të jenë të përcaktuara. Përveç kësaj, një përmirësim i vazhdueshëm në raportimin e emetimeve të ndotësve të Ballkanit Perëndimor është thelbësore për të mbështetur politikën, projektimin dhe vlerësimin.

Për më shumë mbi këtë studim mund të klikoni në "Journal of Environmental Management"

[www.elsevier.com/locate/jenvman](http://www.elsevier.com/locate/jenvman)

### Kompostimi i mbetjeve organike

#### ➤ Ç'farë kuptojmë me Kompostim?

Kompostimi është një proces i ripërdorimit të mbetjeve tona të ushqimit dhe mbeturinave të oborrit për të prodhuar pleh. Pra është një mënyrë e shkëlqyer për të përmirësuar mjedisin e oborrit tonë dhe për të zvogëluar sasinë e mbetjeve organike që shkojnë në depozitim në Landfille ose Incenerator. Kompostimi i kthen mbeturinat shtëpiake në "ar të zi", ose në pleh. Plehrat janë lëndë organike të pasur me lëndë ushqyese që janë dekompozuar në prani të oksigjenit (tretje aerobike). Në shtëpi, mund t'i përdorim këto plehra të prodhura nga kompostimi për lëndinat, vazot e luleve, kopshtin ose bimët e mbjella në shtëpinë tonë. Në kompostim ndikojnë disa faktorë të rëndësishëm: si temperatura, lagështia, oksigjeni, mbetjet të përziera (lloje të ndryshme mbetjesh organike).

#### ➤ Përfitimet e kompostimit:

- Rrit lëndën organike në tokë dhe ndihmon në ndërtimin e strukturës së shëndoshë rrënjore.
- Balancon pH e tokës.
- Bën lëndët ushqyese në tokë më të disponueshme për bimët.
- Devijon mbeturinat e ushqimit nga depozitimet.
- Tërheq krimbat e tokës, të konsideruar si "ricikluesit më të mëdhenj të tokës".
- I bën tokat argjilore të ajrosura në mënyrë që ato të kullojnë më mirë.
- Përmirëson aftësinë e tokave ranore për të mbajtur lagështi dhe për t'i rezistuar erozionit.
- Rrit përmbajtjen e vitaminave dhe mineraleve të ushqimit në një kopësht të pasur me plehra.



### Si mund të shpejtohet procesi i kompostimit?

Prerja e mbetjeve në copëza të vogla është një mënyë për përshtetimin e procesit të kompostimit, duke thjeshtuar më tej punën që do të kryhet nga mikroorganizmat. Sa më të vogla të jenë copëzat, aq më i lartë është aktiviteti biologjik i kompostimit.



Kompostimi në shtëpi i mbeturinave të gjeneruar në kuzhinë dhe oborre, është një rrugë alternative dhe miqësore ndaj mjedisit. Kjo ul sasinë e mbetjeve organike që grumbullohen dhe hidhen në koshat e mbeturinave.

Mbetjet organike të përshtatshme për kompostim janë:

- ✚ Mbetjet ushqimore të gjeneruara nga kuzhina, ndryshe referuar si “të gjelbërta” të cilat janë të pasura me azot. Këtu mund të përfshihen, lëvoret e frutave dhe perimeve, bukë, lëvozhgët e vezëve etj
- ✚ Mbetjet e gjeneruara nga kopshti, si drunjtë, degët e thara, bimë, etj, referuar si “të kafenjta” shumë të pasura me karbon



